Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr.Br. 261-263-280/19
Data/Datum 17.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **KK FERIZAJ.** • **OE Konz. "KNPSH Papenburg&Adriani Company&Eskavatori&Best Company" sh.p.k – Ferizaj,** • **OE Konz.NTP Begisholli&Conex Group" – Ferizaj,** • **OE "Gërlica Company" shpk – Ferizaj,**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Basri Fazliu – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 261/19,263/19 dhe 280/19 të parashtruar nga **OE Konz. "KNPSH Papenburg&Adriani Company&Eskavatori&Best Company" sh.p.k, OE Konz.NTP Begisholli&Conex Group", OE "Gërlica Company" shpk.**		
Datë	17.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt: 29,30 Maj dhe 03 Qershor 2019, me nr.prot. 261/19,263/19 dhe 280/19, të parashtruar nga OE Konz. "KNPSH Papenburg&Adriani Company&Eskavatori&Best Company" sh.p.k, OE Konz.NTP Begisholli&Conex Group", OE "Gërlica Company" shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë të Ferizajit-projekt tre vjeqar", me nr. prokurimi: 656/17/3827/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Ferizaj.
AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.
Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Ministria e Arsimit.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE "KNPSH Papenburg&Adriani Company&Eskavatori&Best Company" sh.p.k – Ferizaj,
- OE Konz.NTP Begisholli&Conex Group" – Ferizaj,
- OE "Gërlica Company" shpk – Ferizaj,
- Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesen e parashtruar nga OE Papenburg&Adriani Company&Eskavatori&Best Company" sh.p.k , OE .NTP Begisholli&Conex Group" , OE "Gërlica Company" shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë të Ferizajit-projekt tre vjeqar", me nr. prokurimi: 656/17/3827/511, **të** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Ferizaj

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I *EKSPERTIT SHQYRTUES*

		06.06.2019	**17.06.2019**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të ekspertit.*	*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

1). Me datën 29,30 Maj si dhe 03 Qershor 2019 OE KNPSH Papenburg&Adriani Company&Eskavatori&Best Company" sh.p.k, OE Konz.NTP Begisholli&Conex Group", OE "Gërlica Company" shpk, kanë parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit të dt.14.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë të Ferizajit-projekt tre vjeqar", me nr. prokurimi: 656/17/3827/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Ferizaj.
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE-ve ankues.

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti kontraktues

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti kontraktues sipas OE "Gërlica-Company"shpk:

Neni 59 i LPP-së,
Neni 62 i LPP-së,

***Dispozitat e shkelura nga Autoriteti kontraktues sipas OE* "KNPSH Papenburg&Adriani Company&Eskavatori&Best Company" sh.p.k:**

Neni 1 i LPP-së,
Neni 10 i LPP-së,
Neni 43 i LPP-së,
Neni 62 i LPP-së,

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti kontraktues sipas OE NTP "Begisholli&Conex Group"shpk:

Neni 1,6,59,62,72,108.4,115.6 te LPP-së, si dhe neni 39.8 i RUOPP

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtujeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ *Jo* ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ **Jo** ☐

Kemi bërë kërkesë për rishqyrtim te AK , mirëpo kërkesa jonë është refuzuar

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur **nenin 59-të LPP-së** sa i përket Ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderit, gjithashtu **nenin 62-të LPP-së** sa i përket përfundimit të aktivitetit të prokurimit për arsye se nuk është shkelur asnjë dispozitë ligjore që ky aktivitet të anulohet.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo disa nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundershtim me vendimin e Organit shqyrtues te prokurimit i cili thotë se lenda duhet te kthehet ne rivleresim dhe jo te anulohet aktiviteti i prokurimit, dhe gjithashtu në këtë procedure nuk është shkelur asnjë dispozite ligjore dhe AK nuk ka pasur arsye ta anuloj sepse edhe buxheti është i ndarë dhe i paraparë nga Ministra e Infrastruktures për këtë projekt si në vitin 2018 ashtu edhe këtë vit 2019.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues-Komuna e Ferizajit, përmes Zyrës së sajë të prokurimit me datën 14.05.2019, ka lëshuar Njoftim për Anulimin e aktivitetit të prokurimit për Tenderin me titull "Asfaltimi I rrugës Pleshinë-Kashtanjevë të Ferizajit , me nr. të prokurimit 656-17-3827-5-1-1, me arsyetimin se një dispozitë e LPP-së e kërkon anulimin e këtij aktiviteti.

Grupi Operatoreve Ekonomik - Konzorciumi KNPSH "Papenburg & Adriani Company_shp.k & Company "Eskavatori"-sh.p.k konsideron, se një përfundim të tillë Autoriteti Kontraktues e ka marrë në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 1, 10, 43, dhe 62. të Ligjit për Prokurimin Publik në aplikim, që Njoftimin për anulim të dates 14.05.2019, e bëjnë të jashtligjshëm dhe të paqëndrueshëm.

Qëndrimi juridik i AK i dhënë në Njoftimin për anulim të tenderit, padyshim se bie ndesh me nenin 62 paragrafi 1 dhe 2. të të LPP-së, sepse një anulim I tillë bëhet:
-pa dhënë donjë arsyetim të veqant lidhur me arsyet e anulimit,
-pa u specifikuar baza ligjore për anulim,
-përkatësisht pa u cekur dispozita konkrete e LPP-së e cila kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimi.

Duke dhënë një eplog të tillë, AK e ka cënuar rendë dispozitën fillestare të LPP-së dhe konkretisht dispozitën e nenit 1. paragrafi 1 dhe 2 të tijë, e cila dispozitë qartë përcakton, se "qëllimi I këtij Ligji /LPP/ është të siguroj mënyrën më efikase dhe më transparente për procedurat tenderuese të cilat do të ndiqen në aktivitetet e prokurimit, përgjegjësinë e zyrtarëve publik që janë të përfshirë në këtë aktivitet, duke kërkuar njëkohësisht që vendimet dhe baza ligjore e vendimeve të tilla të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të LPP-së".

Më pastaj, me një qëndrim të tillë dhe duke vepruar në dëm të operatorëve ekonomik pjesmarrës në tender, AK e ka cënuar edhe dispozitën e nenit 10 paragrafi 1. të LPP-së ka vepruar në kundështim edhe me dispozitën e nenit 10.paragrafi 1. të LPP-së, ngase nuk e ka publikuar Njoftimin e anulimit në formën dhe në përmbajtjen e informatave të përcaktuara nga KRPP-ja dhe nuk I ka përfshirë në të të dhënat e prokurimit, sikur që nuk ka siguruar paraprakisht një Deklaratë me shkrim në të cilën parashtrohen në hollësi arsyet faktike të anulimit dhe baza ligjore e anulimit.

"PAPENBURG+ADRIANI COMPANY" SH.P.K. SOJEVË FERIZAJ

Dispozita e nenit 62. të Ligjit për Prokurimin Publik, në këtë drejtim është dispozitë plotësisht e qartë, kur me paragrafin 2. të sajë përcakton, citojmë:" Kur Njoftimi për kontratë është publikuar dhe procedura e prokurimit është anuluar pa dhënje të kontratës, Autoriteti kontraktues duhet ta publikoj njoftimin e anulimit në formën dhe me përmbajtje të informatave të përcaktuara nga KRPP-ja, të përfshijë në të të dhënat e prokurimit dhe nji deklaratë me shkrim lidhur me arsyet faktike të anulimit dhe bazën ligjore të anulimit".

Njoftimit të Autoritetit Kontraktues që po kontestohet me këtë ankesë, i mungojnë këto elemente qensore , sepse vërtetë në të nuk janë dhënë dhe nuk janë sqaruar arsyet faktike për anulim dhe nuk përshkruhet norma konkrete ligjore e LPP-së e cila e ka kërkuar anulimin.

Njoftimi që po kontestohet me këtë ankesë, pos pershkrimit faktik se kinse një dispozitë e LPP po e kërkon anulimin e prokurimit, ajo dispozitë konkrete e LPP-së nga AK nuk saktësohet, njoftimi si I tillë nuk e përmabë arsyetimin pse po anulohet prokurimi dhe nuk e përmbanë në vehte as këshillën juridike, e cila do ti orjentonte pjesmarrësit në procedurën e ankimimit, e kjo sepse edhe neni 43 I LPP-së kërkon që qdo Njoftim të hartohet në përputhje me formularin standard aplikativ të miratuar nga KRPP-ja.

Dhe meqenëse Njoftimit të kontestuar për anulim të tenderit, I mungon shpjegimi I arsyetimit valid, plotësohen kushtet nga neni 62 të LPP-së që ky Njoftim të anulohet dhe të vazhdohet me procedurën e prokuriimit.

Kjo sepse GOE Konzorciumi KNPSH "Papeburg & Adriani Company" & Company "Eskavatori"-shp.k, në plotni I pati plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e tenderit per dhënien e kontratës.

Mbi bazën e shkeljeve të cituara më sipër, Grupi Operatoreve Ekonomik-Konzorciumi KNPSH "Papeburg & Adriani Company"-sh.p.k & Company "Eskavatori"-shp.k, të paknaqur me Njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr.656-17-3827-5-1-1, duke gjetur mbështetje në dispozitën e nenit 109 paragrafi 1. të LPP-së, në afatin ligjorë, për shkak të: Shkeljeve qenësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Prokurimit Nr.04/L-042, me ndryshim plotësimet e saja;

PROPOZON

Që Organi Shqyrtues I Prokurimit ta pranoj si të bazuar ankesën e parashtruar, ta ANULOJ si të paligjshëm Njoftimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Ferizajit-Zyra e prokurimit të marrë me datën 14.05.2019, për anulimin e tenderit me titull "Asfaltimi I rrugës Pleshinë-Kashtanjevë të Ferizajit"-projekt trevjeqarë, me nr. të

PAPEBURG+ADRIANI COMPANY" SH.P.K. PRIZREN

prokurimit 656-17-3827-5-1-1, dhe autoriteti kontratues të VAZHDOJ procedurën e prokurimit.

Sojevë, 30.05.2019
Konzorciumi:
KNPSH "Papenburg & Adriani Company"sh.p.k & Companya "Eskavatori"-sh.p.k

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim

Konsiderojmë se shkeljet e cekura më lartë kanë shkaktuar humbje të konsiderueshme materiale, kjo nga shkaku se kemi humbje materiale lidhur me kostot që kanë të bëjnë me përgatitjen e ofertave. Kemi poashtu humbje të konsiderueshme edhe sa i përket taksave të cilat jemi obliguar që t'i paguajmë për të siguruar garancionin bankar për sigurimin e tenderit në të gjitha rastet e tenderimit të kësaj kontrate si dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me përgatitjen e ankesave.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

NTP
OE "BEGISHOLLI"

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me rastin e njoftimin e dhënjes së kontratës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e neneve të LPP-së si më poshtë:
Nenin 1.
Neni 6.
Neni 59.
Neni 62.
Neni 72.
Nenit 108A dhe
Neni 115.6
Nenin 39.8 të RUOPP

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne si OE me dt.20.05..2019 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK lidhur me tenderin "Asfalltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë të Ferizajt- projekt 3 vjeçar " me nr.të prok. 615-17-3827-5-1-1.AK me dt.14.05.2019 ka anuluar që aktivitet të prokurimit me arsyetimin se një dispozit e LPP kërkon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.
Të pa knaqur me këtë anulim kemi parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim dhe atë me dt.20.05.2019 me pretendimin se është vepruar në kundërshtim me nenin 59,62 të LPP dhe nenit 72 të po këtij Ligji.

Autoriteti kontraktues me dt.22.05.2019 ka marr vendim me të cilin kërkesën tonë për ri-shqyrtim e refuzon si të pa bazuar me që rast ka bërë:

-Shkelje esenciale të dispozitave të LPP-ës dhe
-Vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.

Ne si OE pjesmarrës në këtë aktivitet të prokurimit nuk pajtohemi me këtë vendim sepse AK ka veproruar në kundërshtim me dispozitat e LPP dhe vendimin e panelit shqyrtues.
Vendimi i panelit shqyrtues të OSHP ës nuk ka rekomanduar AK për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit por ka rekomanduar ri-vlerësimin e tij.
AK me rastin Ri-vlerësimit nuk ka veproruar drejt sepse ri-vlerësimi nënkupton fazën zero dhe vendimi i panelit shqyrtues të OSHP nuk prejudikon se AK nuk ka të drejtë të shpërblej me kontratë OE të rekomanduar më parë me kontratë ashtu siq e parasheh neni 115.6 i LPP ës .
Citat i nenit 105.6 të LPP-ës:"Një vendi i OSHP për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar".

AK me rastin e anulimit nuk ka dhënë arsye bindëse për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit por vetëm me një arsyetim se një dispozit e LPP kërkon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit shtrohet pyetja cila dispozit është kjo.

AK gjatë ri-vlerësimit ka veproruar në kundërshtim me nenin 39 të RUOPP në veçanti me nein 39.8 të RUOPP duke mos përdorur këtë dispozit ku udhëzohet AK si të veprojë në rastet e caktuara lidhur me sqarimin e tenderit.
Nga ky Udhëzuues gjejmë se në rastet kur deklarata e konzorciumin nuk është konform kërkesave të DT , AK ka ip drejtën dhe udhëzohet se mund të kërkohen informata sqaruese.në rastin tonë një veprim të tillë AK nuk e ka ndërrmar.
Po ashtu edhe lidhur me referencat AK sipas këtij udhëzuesi në rast se ka pas paqartësi por edhe nëse mjungojnë referencat sipas këtij udhëzuesi mund të kërkohet informata sqaruese.

AK me rastin e ri-vlerësimit ka dështuar në aplikim të nenit 72 për të sqaruar.kërkuar informacione nga ana e OE lidhur me referencat dhe kontratat e konzorciumit të rekomanduar për kontratë sepse nuk mund të kalohet tek OE tjetër apo të anulohet aktiviteti i prokurimit pa vlerësuar drejt interesin publik në pajtim me nenin 1 dhe 6 të LPP-së.
Autoriteti kontraktues me rastin e anulimit nuk ka veproruar konform nenit 62 të LPP-ës sepse ne kemi qenë OE me qmim më të ulët dhe AK ka mund të përdor edhe nenit 59 dhe 72 në këtë rast ndaj ofertës tonë.

Bazuar në të cekuarat më lartë kërkojmë nga Paneli shqyrtues të marrë këtë:

V E N D I M

1.Aprovohet si e bazuar ankesa e OE"NTP Begisholli&Conex Group"nga Ferizaj me aktivitetin e prokurimit për tenderin".Asfalltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë të Ferizajt-projekt 3 vjeçar " me nr.të prok 615-17-3827-5-1-1.

2.Anulohet vendimi i AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit"Asfalltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë të Ferizajt- projekt 3 vjeçar " me nr.të prok. 615-17-3827-5-1-1 dhe lënda kthehet në ri-vlerësim

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se perfshini pretendime për kompensim.

Ne konsiderojmë se dëmet materiale janë humbja e kontratës me të cilin pësojmë në aspektin financiar.
Shpenzimet e përgaditjeve të tenderit.
Sigurimi i tenderit.
Shpezimet e ankesës
Largimi nga tregu që për ne paraqet dëm në prespektiv dhe imazh të kompanisë tonë
Fitimi i planifikuar për këtë tender

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit-kandidatit, letrës se tenderuesit të pasuksesshëm letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë:	15.08.2017
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Kontrat për punë/vlerë e madhe
Vlera e parashikuar e kontratës:	4,000,000.00€
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave	26.09.2017
Data njoftimit për anulimin e aktivitetit:	16.05.2019
Data e hapjes së ofertave	26.09.2017, ora 14;00
Data e njoftimit mbi vendimit të AK-së	15.05.2019
Leter standarde per tenderuesin eliminuar/ apo pasukseshem	14.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim OE Gërlica-Company SHPK:	17.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim OE KNPSH Papenburg&Adriani Company&Eskavatoti	16.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim OE NTP Begisholli&Conex Group:	20.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesat për rishqyrtim	22.05.2019

Kriteret për vlerësim:

II.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: 1. Deklarata nën betim se OE, i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë sipas kërkesave të LPP- së neni 65 Për OE fitues kërkohet që para shpërblimit të kontratës të dorëzoj: 1.Vërtetimi mbi kryerjen e obligimeve ndaj ATK-(për tremujorin e fundit të vitit [deri ne datën e publikimit të Njoftimit per dhenie te kontrates] 2.Vërtetimi mbi kryerjen e obligimeve ndaj KK-së (për vitin 2016) 3. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente – ekonomike apo autoritetet	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* 1. Deklarata nën betim se OE, i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë sipas kërkesave të LPP- së neni 65 Për OE fitues kërkohet që para shpërblimit të kontratës të dorëzoj: 1.Vërtetimi mbi kryerjen e obligimeve ndaj ATK-(për tremujorin e fundit të vitit [deri ne datën e publikimit të Njoftimit per dhenie te kontrates] 2.Vërtetimi mbi kryerjen e obligimeve ndaj KK-së (për vitin 2016) 3. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente – ekonomike apo autoritetet

administrative të vendit të themelimit të tenderuesit – origjinal apo e noterizuar	administrative të vendit të themelimit të tenderuesit – origjinal apo e noterizuar
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: 1.Çertifikata e Biznesit për veprimtari adekuate, 2.Çertifikata e numrit fiskal, 3.Çertifikata e TVSH-së,	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* 1.Kopje- Çertifikata e Biznesit për veprimtari adekuate, 2.Kopje- ertifikata e numrit fiskal, 3.Kopje- Çertifikata e TVSH-së,
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 1.Operatori ekonomik duhet te ofroje nje vlere jo me pak se 4,000,000.00 € ne lidhje me punet e ngjashme ne tri vitet e fundit (2014-2016) 2.Stafi profesional: a.Një inxhinier i ndërtimtarisë b.Një gjeodet te licencum	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* 1.Lista e kontratave (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik duhet te ofroj listen e kontratave te realiziara gjate tri viteve te fndit ne original, te nenshkruar dhe vulosur nga OE, te deshmuar me referenca ose pranime teknike te puneve , te kryera ne lemin e ndertimit dhe puneve te ngjashme, te cilat tregojne vleren, daten, llojin dhe vendin e projektit punues ose aktiviteteve te nderti mit / certifikat e pranimit. 2.Stafi profesional: a.Një inxhinier i ndërtimtarisë , të argumentuar me diplomë universitare (kopje të vërtetuar –origjinal) dhe kontratë të punës valide, b. Një gjeodet , të argumentuar me licence valide .Licenca dhe diploma duhet te ofrohen kopje te vertetuara

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	Kodi Tenderi	Çmimi	Vërtetje
1	OE "2A GROUP"SHPK	Prishtinë	102469	3,147,049.00€	JO
2	KONZ. "BURIMI-E&EUROTRANS&BENI COM" SHPK	Komogllavë	102471	3,197,991.30€	JO
3	KONZ. "RAHOVICA COMERCE&GASHI-ING"	Ferizaj	102475	4,051,040.80€	JO
4	KONZ. "BERISHA COMPANY&ARLINDI"SHPK	Ferizaj	102479	4,125,598.00€	JO
5	KONZ. "ESKAVATORI&PAPENBURG&	Ferizaj	102485	3,999,537.10€	JO

- Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesen e parashtruar nga OE Papenburg&Adriani Company&Eskavatori&Best Company" sh.p.k , OE .NTP Begisholli&Conex Group" , OE "Gërlica Company" shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë të Ferizajit-projekt tre vjeqar", me nr. prokurimi: 656/17/3827/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Ferizaj.

	ADRIANI&BEST COMPANY"				
6	JEHONA SHPK	Malishevë	102491	3,433,950.75€	JO
7	OE "GËRLICA COMPANY" SHPK	Ferizaj	102498	3,250,024.80€	JO
8	KONZ. "BEGISHOLLI&CONEX GROUP" SHPK	Ferizaj	102502	2,777.777.77€	JO
9	OE "BAGERI"	Ferizaj	102510	4,016,772.20€	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë nëntë (9) operator ekonomik, në hapje nuk është rexhistruar asnjë vërejtje.

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit ri-vlerësues.

Eksperti shqyrtues gjate shfletimit te dokumentacionit per kete aktivitet nuk kemi hasur ne raport te rivlerësimit e formuar nga Autoriteti kontraktues.

Nuk ka raport te rivlerësimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues KNPSH Papenburg&Adriani Company&Eskavatori&Best Company" sh.p.k, OE Konz.NTP Begisholli&Conex Group", OE "Gërlica Company" shpk:

Përgjigje në Pretendimi nr.1, OE *KNPSH Papenburg&Adriani Company&Eskavatori&Best Company" sh.p.k, OE Konz.NTP Begisholli&Conex Group", OE "Gërlica Company" shpk:*

Lidhur me pretendimin ankimore të Operatoreve ekonomik ankues të larte cekur sa i përket arsyetimit për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit nga ana Autoritetit kontraktues Komuna Ferizaj bazuar ne ate qe eshte përshkruar ne Njoftimin per anulim ku thuhet: "***nje dispozit e LPP-së kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit, e parapare ne nenin 62 te LPP-së".***

Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se ky aktivitet i prokurimit eshte kthyer ne rivlerësim nga ana e OSHP-se ne baze te vendimit nr.483,485/17 te dt.27.12.2017. Autoriteti kontraktues me dt.14.05.2019 ka publikuar Njoftimin per anulimin e aktivitetit te prokurimit.

Eksperti shqyrtues njeherit sqaron se kemi te bejme me nje pretendim ankimor kunder anulimit te këtij aktivitetit ndaj ankesat OE-ve kane nje pretendim te vetem ankimor, në lidhje me pretendimet ankimore të parashtruar nga Operatoret Ekonomik te larte cekur ankues sa i përket anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit sipas arsyetimit të dhënë nga ana Autoriteti kontraktues, ***vlerësoj*** se NUK qëndron arsyetimi i dhënë bazuar në nenin 62 të LPP-së, sepse Autoriteti kontraktues nuk ka ofruar asnjë dëshmi në lidhje me arsyetimin për anulim te këtij aktiviteti. Poashtu Autoriteti kontraktues ne njoftimin per anulim vetëm thekson duke u thirrur në nenin 62 te LPP-se pa ofruar ndonjë të dhënë të saktë provë apo dokument që dëshmon sipas nenit 62 të LPP-së, paragrafi 1.1. Poashtu ky aktivitet i prokurimit fillimisht është vlerësuar duke rekomanduar për dhënien e kontrates, por i njejti aktivitet pas vendimit të OSHP për të kthyer në rivlerësim këtë procedur ndersa AK-ja ka bërë anulimin aktivitetit të prokurimit.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin e AK-së si dhe arsyetimin e dhënë për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit mendoj se nuk është sqaruar dhe arsyetuar vendimi per anulimin e procedures konform nenit 62 të LPP-së, siç kërkohet nje arsyetim detal me te dhena faktike konform këtyre dispozitave për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Eksperti shqyrtues ne lidhje me pretendimet tjera ankimore te parashtruar nga ana OE ankues NTP ***Begisholli&Conex Group****, sa i perket referencave dhe formularit te tenderit si dhe nenit 72 te LPP-se per ti qaruar keto dokumente, njoftoj panelin shqyrtues ne harmoni me Rregulloren e brendshme te OSHP-se neni 16.2 e te njëjtat pretendime ankimor jane shqyrtuar paraprakisht ne baze te vendimit P. SH.nr. 483/17 dhe 485/17 , dhe lenda eshte kthyer ne rivlerësim.*

Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues Rekomandon qe te aprovohen si te bazuar ankesat e parashtruar nga operatoret ekonomik ankues te larte cekur, njeherit ky aktivitet i prokurimit te kthehet ne rivlerësimt.